

Vula e përkthyeses Tatiana Maridysova
Diplomuar ne fililogji gjuha portugeze

E Pesta marëveshje e ndryshimit të
Lusiana do Brasil Comercio Internacional e prezantuar shpk

Me këtë dokument të posaçëm Ruy Antonio Reis Alves , braziljan, i martuar, nënshtetas i shtetit Rio de Janeiro , ekonomist , me banim në këtë qytet me adresë Rua Maria Quitera , Nr.22 , shtëpia 302 , në Ipanema , mbajtës i dokumentit të indentifikimit, lëshuar nga Instituti Felix Pacheco, Nr.1.569.024 dhe CIC Nr. 380.388.897-20 , si dhe Ricardo Vieira Ferreira Martins , braziljan , nënshtetas i shtetit Rio de Janeiro , ekonomist , i martuar ,me banim në këtë qytet me dresë Rua Conde de Bonfim,Nr.616 , shtëpia 201 , mbajtës i dokumentit të indentifikimit Nr.2172354 , lëshuar nga Instituti Felix Pacheco dhe CIC nr. 260.501.617-04 , janë të vetmit ortakë të krijimit të shoqërisë me veprimtari të kufizuar, të quajtur Lusiana do Brasil Comercio Internacional e prezantuar Shpk, marëveshja e tyre e përbashket dhe dokumenti i tyre i fundit u arkivua në këshillin e tregëtisë të shtetit Rio de Janeiro, me numurin ./.133.200.773.809 dhe 3555577 , kryer me date 22.11.1982 dhe 26.1.1987 , ranë dakort midis tyre dhe në përputhje te përbashkët, të ndryshojnë marrëveshjen e fundit , që të kryejnë ndryshimin e adresave të selive dhe kontrata e re përcakton klauzola dhe kushte si me poshtëshënuar.

E para:

Shoqëria vepron me emrin Lusiana do Brasil Comercio Internacional e prezantuar shpk dhe çvendos adresën e selisë nga Av.Rio Branco Nr. 177 , kati 7, Centro- Rio de Janeiro në adresën Rod. Amaral Peixoto Km 87 ,-Rodoshop – Modulo 16, Loja A-Araruama , Est .Rio da Janeiro , dhe mund të hapë filiale në çso pjesë të teritorit kombëtar.

E dyta.

Shoqëria do të veprojë në një kohë të pakufizuar.

E treta.

Objekti i veprimtarisë të shoqërisë-tregëti dhe përfaqsim me emrin e vet ose nëpërmjet të një personi të treta,të prodhimeve bujqësore-blektorale ,përfaqsim , pjesmarje në veprimtari të blerjes dhe shitjes te floririt në lingota dhe llojeve të tjera të metaleve, makinerive dhe paisjeve për industrinë , si dhe kryerjen e shërbimeve konsulence.

E katërta.

Kapitali i përbashkët është NCzS 500,00(pesëqind cruzados te reja) , të ndara në 500(pesëqind) pjesë ne vlerë NCzS 1,00(nje cruzado e re) sejcila nga ato, të gjitha të shënuara dhe të vendosura nga ortakët gjatë këtij akti ne monedhën e zakonëshme kombëtare në formën e poshtëshënuar.

Ortakët

Ruy Antonio Reis Alves
Ricardo Vieira Frreira Martins

Pjesa	Vlefte
495	NCzS 495,-
<u>5</u>	<u>NCzS 5,-</u>

Përgjegjësia e shoqërisë është e kufizuar nga vlefata e përgjithshme e kapitalit të shoqërisë duke respektuar përjashtimet e parashikuara nga ligji.

E pesta.

Të drejtën e firmës e kanë të dy ortakët ,sejçili (veç e veç) , por vetëm në rastet kur ato janë në interes të shoqërisë, por është e ndaluar përdorimi i firmës në avalech , për të garantuar ose favorizuar çdo person tjetër të tretë.

E gjashta.

Ortakët marrin një kuotë (pagë) mujore që arrijn deri në kufirin e lejuar nga rregullat e shkruara për tatimin nga të ardhurat , të cilat i zbriten fitimeve dhe humbjeve.

E shtata.

Arka dhe administarta e shoqërisë varen nga të dy ortakët , të cilët janë të çliruar nga vendosja e kuotës , parashikuar në nenin 12 , të ligjit nr. 3.708.

E teta.

Fitimet dhe humbjet , të cilat do të rezultojnë në bilancin e përgjithshëm, i cili del me 31 Djetor të çdo viti, do të ndahet ose do të mbulohet nga ortakët në raport me pjesët e tyre që kanë në kapital,

E nënta.

Ortakët nuk mund të shesin ose të tërheqin të gjithë kuotat e tyre të kapitalit bazë , pa ja ofruar më parë ortakut të vet me shkrim duke i lënë një afat për përgjigje deri në 30 ditë dhe gjithmonë ortakut i dytë ka prioritet përpara të tjerëve në rast se ka interes të blejë pjesën e kapitalit të ortakut.

E dhjeta.

Në rast se vdes njëri nga ortakët e shoqërisë atëhere shoqëria shkrihet pas kryerjes së inventarit ku nxiren pasuritë e ortakut të vdekur për tu a kaluar trashëgimtarëve sipas menyrës së mëposhtme:

30% (tridhjet përqind) menjëherë dhe pjesa tjetër në 24(njëzetekatër) pagesa të barabarta për çdo muaj,ku pagesa e parë do kryhet 30(Tridhjetë) ditë pas pagesës të menjëhershme në fillim.

E njëmbëdhjeta.

U zgjodh gjykata e rrethit Araruama te shtetit Rio de Janeiro, duke përjashtuar çdo tjetër gjykatë , që të zgjidhë çdo lloj keqkuptimi që rrjedh nga ky dokument.
Dhe për arsye se kështu rane dakort , me drejtësi dhe me marrëveshje ,nenshkruajnë këtë document, në 3 (tre) faqe , me përmbajtje dhe qëllim të njëjtë si dhe dy dëshmitarë.

Araruama , 19.Maj 1989.

Ruy Antonio Reis Alves
Ricardo Vieira Frreira Martins

Ky është ndryshimi i pestë i marrëveshjes te
Lusiana do brasil Comercio Internacional e prezantuar Shpk
Dëshmitarët:
Adriano Rocha
Elis Regina G. De Albuquerque

Në faqen e mëparëshme vula trekëndëshe me tekst:
JUCERJA- është shkurtimi i fjalise:Dhoma e tregëtisë të shtetit Rio de Janeiro.
Dhoma e tregëtisë e shtetit Rio de Janeiro

VERTETIM

Vërtetohet që kjo kopje përputhet me dokumentin e fundit , të arkivuar këtu më
20.11.1996.

Përgjegjësi i sektorit të arkivit
Më poshtë është vula e palexueshme.
Sekretariati
Vilson da Silva
JUCERJA , firma e palexueshme.

Shënim i përkthyesit

Si përkthyes i gjuhës portugeze , emëruar me vendimin e gjykatës të qytetit të Prages datë
26.11.96 , nr. 215 ,

Vvërtetohet se përkthimi përputhet me tekstin e fletës bashkelidhur.

Veprimtaria e përkthimit është regjistruar me nr. 166/96

Prage 27.11.96 Firma e përkthyeses
Tatjana Mandysova

Vula

Përkthyes Tatjana Mandysova
Diplomuar në fliologji gjuha portugeze

13
Verifikim .

Verifikova , që ky përshkrim i plotë përmban 7 fletë ,
Perputhet fjalë për fjalë me fletët origjinale prej 7 fletësh.

Prage date 29.3.2006

Mgr.Alexandra Cervova

Përfaqësues i përhershëm

JUDr. Blanka Cechove

Notere me seli në Pragë

Firma

vula e rrumbullakët : JUDr.Blanka Cechova , notere ne Prage

Përktheu ing.Vasil Lato

Vasil Lato

